




Rishikim i projeksioneve makroekonomike – nëntor 2023 –

dr. Anita Angellovska-Bezhoska
guvernatorja




Goditje globale me efekte të forta dhe afatgjata

- Në disa vitet e fundit bota është përballur me më shumë **goditje të njëpasnjëshme me përmasa të papara**, efektet e të cilave janë të dukshme në disa segmente:
 - **Ekonominë globale**, që në periudhën 2020-2023 pësoi humbje të rënda, të cilat vlerësohen me PBB-në më të ulët për rreth 4% krahasuar me parashikimet para pandemisë, me humbje më të mëdha në ekonomitë më pak të zhvilluara, përfshirë Ballkanin Perëndimor (rreth 5% PBB më e ulët).
 - **Inflacionin global**, që është rritur me norma të pa regjistruara në 25 vitet e fundit, vitin e kaluar duke arritur mesatare prej rreth 9%, ndërsa në ekonomitë më pak të zhvilluara ka arritur nivele dyshifrore – në EQJL-në arriti 13,3%. Këtë vit është duke u ngadalësuar ndjeshëm, por vazhdon të jetë mbi mesataren historike për shumicën e ekonomive.
 - **Rrezikun e ri me të cilin jemi përballur këtë vit që është (jo)stabiliteti financiar**, i cili u manifestua përmes dështimit të disa bankave në ShBA, megjithatë si rezultat i reagimit të shpejtë të rregullatorit, nuk kishte transmetimin e konsiderueshëm të efekteve të rëndësishme në shkallë më të gjerë.



Burimi: Pasqyra ekonomike botërore, tetor 2023



Burimi: Pasqyra ekonomike botërore, tetor 2023.





Sipas parashikimeve të fundit të FMN-së, efektet negative të goditjeve do të ndihen edhe në afat të mesëm, por me intensitet më të lehtë

- **FMN-ja parashikon norma të rritjes së aktivitetit ekonomik botëror në periudhën 2023-2025 me mesatare prej 3%.** Nga pikëpamja dinamike, pas rritjes prej 3,5% në vitin 2022, për vitin aktual dhe vitin e ardhshëm pritet ngadalësim i rritjes globale (3% dhe 2,9%, përkatësisht), dhe më pas përsheptim i moderuar në 3,2% për vitin 2025. Ngadalësimi është i **pabalancuar**, respektivisht është më i theksuar në ekonomitë e zhvilluara.
- **Kjo dinamikë e rritjes globale është nën mesataren e dy dekadave të fundit** dhe është pasqyrim i pasojave afatgjata të pandemisë, luftës në Ukrainë, fragmentimin gjeo-ekonomik të rritur, si dhe kushtet e shtrënguara financiare dhe më pak mbështetje fiskale gjatë nevojës për konsolidim fiskal.
- **Këto vlerësime të fundit për rritjen nënkuptojnë rritje disi më të ulët globale për vitin e ardhshëm**, duke përfshirë edhe të BE-së, në raport me parashikimet e prillit.
- **Inflacioni global pritet të vazhdojë të bie**, respektivisht të ngadalësohet në 6,9% në vitin 2023, dhe në 5,8% në vitin 2024 dhe 4,6% në vitin 2025, por me ritëm pak më të ngadaltë se më parë, kryesisht për shkak të këmbënguljes më të madhe të inflacionit bazë.

Rreziqet për rritjen ekonomike mbeten kryesisht në rënie, ndërsa për inflacionin, kryesisht në rritje:

- Lufta në Ukrainë
- Konflikti ushtarak Hamas-Izrael
- Rritja më e dobët e ekonomisë kineze si e dyta më e madhe në botë
- Shtrëngim i mëtejshëm i kushteve financiare ndërkombëtare
- Rritja e stresit financiar të vendet me huamarrje të lartë
- Rritja e fragmentimit gjeo-ekonomik të ekonomisë globale e cila mund të ulë PBB-në globale me 0,2%-12% në varësi të kanaleve dhe intensitetit, por edhe përballjen e ekonomive me këtë rrezik



Burimi: Pasqyra ekonomike botërore e FMN-së, tetor 2023.



Çfarë do të thotë ky mjedis global për kërkesën e eksportit të produkteve dhe shërbimeve tona?

- Si deri tani, pritet që kërkesa e huaj të ngadalësohet, ndërsa vitin tjetër të përshpejtohet në mënyrë të moderuar, por me intensitet më të dobët se parashikimet e prillit (rritje prej 1%, në vend të 1,7%), si rezultat i ngadalësimit të të gjithë partnerëve më të rëndësishëm tregtarë, veçanërisht në Gjermani (recesion).
- Në afat të mesëm, rritje e përshpejtuar prej 1,7%.






Burimi: "Consensus Forecasts" dhe llogaritjet e BPRMV-së`



Çfarë do të thotë ky mjedis global për çmimet tona të importit dhe eksportit?

- Në përgjithësi, pas rritjes së lartë të çmimeve të produkteve parësore në dy vitet e mëparshme, pritshmëritë e tregut dhe të INF-ve janë në drejtim të rënies së çmimeve në periudhën 2023-2024 dhe kryesisht stabilizimit të tyre në vitin 2025.
- Në krahasim me parashikimet e prillit :
 - Tek energjentët priten çmime mesatarisht më të ulëta për këtë vit dhe më të larta për vitin e ardhshëm;
 - Tek ushqimet dhe metalet priten çmime më të ulëta;
 - Tek inflacioni i huaj efektiv është bërë rishikim në rritje për vitin aktual, ndërsa për vitin 2024 vlerësimet janë të pandryshuara, me çka, norma e rritjes pritet të ngadalësohet nga 7,5% (6,9% në prill) këtë vit, në 3,3% vitin e ardhshëm dhe 2,5% në vitin 2025;
 - Në përgjithësi, krahasuar me parashikimet e prillit, kjo tregon për kushte disi më pak të favorshme tregtare për shkëmbim.





Supozimet kryesore për parashikimet e ekonomisë maqedonase

- **Ekonomia globale dhe kërkesa e huaj** do të vazhdojnë rimëkëmbjen, edhe pse me dinamikë disi më të ngadaltë nga pritshmëritë.
- **Çmimet e bursës** do të vazhdojnë të bien, megjithatë të energjentëve me dinamikë disi më të ngadaltë.
- **Mungesa e turbulencave të konsiderueshme në tregjet financiare ndërkombëtare**, megjithëse ato do të mbeten të shtrënguara si reflektim i ciklit të shtrëngimit të politikës monetare të bankave qendrore dhe pasigurive ekzistuese.
- **Konsolidimi fiskal do të vazhdojë edhe në periudhën afatmesme në pajtim me SF 2024-2028**, deficitit buxhetor nga 4,5% i PBB-së së vitit të kaluar do të zbres në përafërsisht 3% e PBB-së në vitin 2025, duke u mbështetur në burimet e financimit të brendshëm dhe të jashtëm.
- **Intensifikimi i investimeve publike në infrastrukturë**, sidomos nga viti 2024 e në vazhdim, si dhe investime solide të huaja dhe vendase, veçanërisht në burimet e ripërtëritshme dhe në sektorin e eksportit.




Skenari makroekonomik 2023 - 2026



Parashikimi i PBB-së


- Sipas lëvizjeve në kërkesën e huaj efektive, këtë vit pritet ngadalësim i moderuar i rritjes ekonomike, dhe më pas përsheptim gradual në periudhë afatmesme.
- Për këtë vit parashikojmë rritje prej **1,9%**, ndërsa për vitin e ardhshëm **3%**. Kjo do të thotë korigjim i moderuar në rënie në raport me parashikimet e muajit prill që është konsistente me rishikimin në rënie të kërkesës së huaj për gjysmën e dytë të këtij viti dhe të vitit të ardhshëm.
- **Arritjet në gjysmën e parë të këtij viti** ishin më të mira nga parashikimet (1,6% kundrejt 1,2%), por treguesit afatshkurtër për tremujorin e tretë tregojnë ngadalësim, e cila në bazë neto do të rezultonte në rritje disi më të ulët për vitin 2023.
- **Në afat të mesëm** në linjë me mjedisin e pritur më të favorshëm global (kërkesa e huaj), pritet përsheptim gradual i rritjes. Megjithatë, pasiguria dhe rreziqet globale mbeten të pranishme.





Parashikimi i PBB-së 2023-2025


- **Për sa i përket strukturës së rritjes**, në vitin 2023 dominues do të jetë kontributi i eksporteve neto, ndërsa në plan afatmesëm është kërkesa e brendshme
 - **Investimet** – do të kenë kontribut dominues me rritje mesatare prej 5,8%, të mbështetur nga investimet publike dhe private, në kushte të investimeve të huaja direkte solide dhe rritjes së kredisë.
 - **Konsumi personal** – rritje mesatare prej 2,7%, e mbështetur kryesisht nga rritja e të ardhurave të disponueshme.
 - **Aktiviteti eksportues** – rënie e vogël këtë vit për shkak të kushteve të pafavorshme të çmimeve të metaleve dhe nga rritja e ngadaltë e partnerëve më të rëndësishëm tregtarë, dhe më pas rritje prej 3,5% në vitin 2024-2025, në pajtueshmëri me rimëkëmbjen e kërkesës së huaj dhe kontributin e mëtejshëm të kompanive në industrinë e automobilave.
 - **Importi** - në pajtim me rimëkëmbjen e kërkesës së huaj dhe kontributin e mëtejshëm të kompanive në industrinë e automobilave, këtë vit pritet rënie, ndërsa më pas rritje mesatare prej 4,0% në dy vitet e ardhshme, në pajtueshmëri me rritjen e eksporteve dhe të kërkesës së brendshme, me çka eksportet neto do të kenë mesatarisht kontribut të vogël negativ.





Parashikimi i inflacionit

- Edhe në këtë cikël të projeksioneve është ruajtur kahja e rregullimit të rënies së vazhdueshme të inflacionit deri në fund të periudhës së parashikimit.
- Pas rritjes së lartë të çmimeve, nga nëntori i vitit të kaluar e në vazhdim inflacioni është vazhdimisht në rënie ndërsa në tetor të këtij viti norma vjetore u ul në 3,5%, me rënie të theksuar të çmimeve të produkteve parësore, rritja e ngadalësuar e inflacionit efektiv të huaj, shtrëngimi i politikës monetare dhe masa të tjera rregullatore.
- Edhe pse norma vjetore është duke u ngadalësuar ndjeshëm, megjithatë, për shkak të normave më të larta në fillim të vitit, norma mesatare në periudhën janar-tetor është 10,7%.
- Duke marrë parasysh këto lëvizje të favorshme, pritet që inflacioni mesatar të vazhdojë të ngadalësohet dhe për këtë vit të jetë përafërsisht 9,5%, vitin e ardhshëm të ngadalësohet më tej në 3,5%-4%, dhe më pas të stabilizohet rreth mesatares afatgjatë prej 2%.
- Në krahasim me muajin prill, kjo nënkupton korrigjim të moderuar në rritje të inflacionit për këtë vit duke marrë parasysh realizimet pak më të larta (ushqimore) dhe çmimet më të larta të importit.
- **Megjithatë, rreziqet rritëse rreth inflacionit janë akoma të pranishme** dhe në përgjithësi lidhen me: çmimet e produkteve parësore, ndryshimet në çmimet e rregulluara, si dhe me politikat e kërkesës (të ardhurat e disponueshme).





Krahasimi i parashikimeve për PBB-në dhe për inflacionin e ekonomisë tonë

Krahasim i parashikimeve për PBB-në dhe inflacionin e Maqedonisë së Veriut nga organizata të ndryshme

Organizata	Muaji i publikimit	Rritja reale e PBB-së, %			Inflacioni (norma mesatare, %)		
		2023	2024	2025	2023	2024	2025
FMN	tetor 2023	2.5	3.2	3.5	10.0	4.3	2.2
Banka Botërore	tetor 2023	1.8	2.5	2.9	9.1	3.0	2.0
Komisioni European	maj 2023	2.0	3.1	-	7.9	3.7	-
BERZH	shtator 2023	2.0	3.0	-	-	-	-
Consensus Forecast	tetor 2023	1.9	2.8	-	9.2	4.0	-
Ministria e Financave	prill 2023	2.5	4.0	5.0	8.9	2.5	2.0
Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut	tetor 2023	1.9	3.0	4.0	9.5	3.5-4.0	2.0


Burimi: FMN-ja, Pasqyra ekonomike botërore, tetor 2023; Banka Botërore, Raport i rregullt ekonomik për Ballkanin Perëndimor, vjeshtë 2023; Komisioni European, Parashikimet për ekonominë europiane, pranverë 2023; BERZH, perspektivat ekonomike rajonale, shtator 2023; Consensus Forecast, tetor 2023; Ministria e Financave, Strategjia fiskale 2024-2028, prill 2023; dhe Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut, tetor 2023.



Bilanci pagesor

- llogaria rrjedhëse -


- **Lëvizjet në pozicionin e jashtëm janë më të favorshme**
- **Pas thellimit të madh të deficitit të llogarisë rrjedhëse vitin e kaluar në 6,2% të PBB-së** (i nxitur nga bilanci tregtar i energjisë), këtë vit deficitin shënon përmirësim të dukshëm.
- **Në gjysmën e parë të vitit 2023, është ulur në 0,1% e PBB-së**, i nxitur kryesisht nga ngushtimi i deficitit tregtar, gjatë rënies së çmimeve të energjisë dhe arritjeve pozitive të kompanive në zonat.
- **Duke pasur parasysh këto arritje pozitive** për gjithë vitin 2023 deficitin është ulur në nivel prej 1,2% të PBB-së.
- **Në periudhën afatmesme, deficitin i llogarisë rrjedhëse vlerësohet për rreth 2,4% të PBB-së** me pritje pak më të ulëta të transfertave private pak më të ulëta (pas arritjeve të larta në periudhën e kaluar) dhe deficit pak më të lartë të të ardhurave parësore.
- **Krahasuar me parashikimet e prillit**, realizimet e deritanishme janë dukshëm më të mira, dhe rrjedhimisht bëhet korrigjim në rritje në periudhë afatmesme.





Bilanci pagesor - llogaria financiare -

- **Flukset hyrëse në llogarinë financiare pritet të jenë mesatarisht 3,6% të PBB-së,** kryesisht në formën e investimeve të huaja direkte dhe huamarrjes së jashtme të shtetit.
- Duke qenë se do të jenë më të larta se deficitin e llogarisë rrjedhëse, do të mundësojnë rritje të mëtejshme **të rezervave valutore.**
- Që aty, **treguesit e mjaftueshmërisë së rezervave valutore,** gjatë gjithë periudhës së parashikimit, do të qëndrojnë në zonën e sigurt.
- **Në raport me parashikimet e prillit, kjo do të thotë nivel më i lartë i rezervave valutore.**







Rritja e depozitave dhe kredive

- **Pritet që sistemi bankar të vazhdojë të ofrojë mbështetje solide kreditore,** edhe pse disi më të moderuar, në rrethana të shtrënguara monetare dhe masave makroprudenciale të ndërmarra.
- Rritja e kreditimit në tremujorin e tretë të këtij viti është 5,8%, dhe në fund të vitit do të ishte rreth 5,7%, njësoj si në parashikimet e prillit.
- **Në afat të mesëm, në vitin 2024 - 2026, pritet rritje mesatare e kredive prej rreth 6,9%,** në kushtet e rritjes së mëtejshme të kapitalizimit (18%) dhe likuiditetit solid të sistemit bankar (30% e pjesëmarrjes së aktiveve likuide), me cilësi solide të aktivës.
- **Depozitat, si burimi më i rëndësishëm i financimit, shënuan rritje vjetore prej 9,0% në tremujorin e tretë, më e fortë se sa pritej** (7,4% sipas parashikimeve të prillit), gjatë stabilizimit të pritshmërive dhe forcimit të besimit, dhe në të njëjtën kohë norma e kthimit në rritje të kursimet, për të cilat kontribuojnë edhe masat monetare të marra.
- **Deri në fund të vitit 2023** presim rritje solide të depozitave që do të arrijnë **8,4%**, ndërsa **në afat të mesëm** për periudhën prej vitit 2024 deri më 2026 për rreth **7,8%, mesatarisht.**

Rritje e kredive



Rritje e depozitave





PËRMBLEDHJE

- **Sipas parashikimeve të FMN-së, ekonomia globale do të vazhdojë të rritet, por me ritëm disi më të ngadaltë.**
- Me supozime më pak të favorshme për mjedisin e jashtëm dhe faktorët e brendshëm në afat të shkurtër, pritet që **ekonomia maqedonase** të rritet me normë prej 1,9% këtë vit, dhe më pas në linjë me rimëkëmbjen e ekonomisë globale, rritja duhet të përshpejtohet në mënyrë të moderuar në periudhën afatmesme.
- **Inflacioni** pritet të vazhdojë të ngadalësohet, njejt si edhe inflacioni global, këtë vit do të ulet në nivel njëshifror. Në afat të mesëm do të vazhdojë të ngadalësohet dhe të kthehet në mesataren historike.
- Në kushtet e stabilizimit të tregjeve të produkteve parësore, **pozicioni i jashtëm** i ekonomisë është dukshëm më i mirë nga pritshmëritë, me efekt pozitiv mbi rezervat valutore të cilat mbeten në zonën e sigurt. Është në funksion të forcimit të mëtejshëm të stabilitetit të kursit të këmbimit.
- Megjithatë, mjedisi global mbetet i pasigurt dhe i paparashikueshëm, gjë që paraqet **rrezik** pas rritjes ekonomike, inflacionit dhe pozicionit të jashtëm, duke theksuar kështu nevojën për politika të brendshme të matura makroekonomike dhe strukture.
- **Me qëllim stabilizimin e pritjeve inflacioniste dhe normës së inflacionit, si dhe tregun valutor, Banka Popullore duke filluar që nga fundi i vitit 2021 ka shtrënguar vazhdimisht politikën monetare.** Shtrëngimi është zbatuar nëpërmjet disa instrumenteve, duke përfshirë edhe përmes normës së interesit e cila u rrit 14 herë. Në disa raste është ndërhyrë përmes instrumentit të rezervës së detyrueshme , por edhe përmes masave sistematike, siç është shtesa mbrojtëse kundërciklike e kapitalit dhe masat makroprudenciale të lidhura me cilësinë e kërkesës për kredi, gjë që forcon më tej rezistencën e sistemit bankar.
- Në takimin e fundit të KOMP-it norma e interesit ka mbetur e pandryshuar për shkak të ngadalësimit të mëtejshëm të inflacionit, lëvizjeve të favorshme në tregun valutor, masat makroprudenciale që kanë hyrë në fuqi së fundmi, si dhe ndryshime në RD-në të cilat hyjnë në fuqi këtë muaj dhe muajin tjetër. Është marrë parasysh edhe pozicionimi i politikës monetare të BQE-së.
- ***Banka Popullore i ndjek me kujdes të dhënat makroekonomike dhe rreziqet në baza ditore dhe si deri tani, do të marrë të gjitha masat e nevojshme, duke përdorur të gjitha instrumentet në dispozicion, për ruajtjen e stabilitetit të kursit të këmbimit valutor dhe stabilizimin e inflacionit në afat të mesëm.***



*JU FALEMINDERIT PËR
VËMENDJEN!*